

BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE - ALPEX SH.ANr. 256 Prot.Tiranë, më 03/11 /2022

Lënda: Informim mbi produktet dhe llojet e urdhërporosive që do të tregtohen fillimisht në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a.

Drejtuar: **Entit Rregullator të Energjisë**
Bulevardi “Bajram Curri”, Rruga “Viktor Eftimiu”, Nr. 1023, Tiranë.

I nderuar z. Ahmeti,

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a, në kuadër të detyrimeve dhe angazhimeve të ndërmarra, tashmë në cilësinë e të licencuarit si Operator i Tregut të Energjisë Elektrike, sipas vendimit të Bordit të ERE nr. 247, datë 29.09.2022, duke pasur parasysh rolet dhe përgjegjësitë e këtij funksioni është duke punuar për të propozuar pranë Entit Rregullator të Energjisë plotësimin e kuadrit të nevojshëm rregullator në lidhje me aktivitetin e saj.

Në vijim të kërkesës së paraqitur nga ana e ALPEX-it për miratimin e Rregullave dhe Procedurave të ALPEX, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a, Ju informon mbi produktet dhe llojet e urdhërporosive që do të tregtohen fillimisht në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a.

Ky informacion ju behet me dije duke marrë në konsideratë gamen e produkteve dhe llojet e urdhërporosive të cilat janë parashikuar në dokumentin e Procedurës së Tregtimit, e cila është dërguar pranë jush me anë të shkresës Nr. 201 Prot. datë 29.08.2022 për miratim. Kjo Procedure parashikon në kapitullin B, llojet e produkteve dhe llojet të Urdhërporosive Tregun e Ankandit e Ditës në Avancë. ALPEX fillimisht do të prezantojë produkte orare ndërkohë llojet e Urdhërporosive Shitjeje dhe Blerjeje të parashikuara janë si më poshtë:

- (a) Urdhërporosi e Thjeshtë (Simple Orders);
- (b) Urdhërporosi në Bllok (Block Orders);
- (c) Urdhërporosi të Lidhura në Bllok (Linked Block Orders);
- (d) Grupi Ekskluziv i Urdhërporosive në Bllok (Exclusive Group of Block Orders).

Në kushtet kur me fillimin e operimit të ALPEX, mungesa e likuiditetit të mjaftueshëm do mund të sillte që në disa Njësi Kohore Tregu të pamundësohej rezultati dhe për rrjedhojë do të krijonte probleme në implementimin e Urdhërporosi në Bllok.

Nominimet në Ankandin e Ditës në Avancë me Urdhërporosi në Bllok (Block Orders, Linked Block Orders & Exclusive Group of Block Orders) teknikisht janë më komplekse dhe kërkojnë një afat më të gjatë për tu adaptuar me mënyrën e nominimit, në mënyrë që të evitohet rreziku i dështimit të shpalljes fitues të Anëtarëve të Bursës në ankandin e Ditës në Avancë për Njësi Kohore Tregu (MTU) të caktuara.

Tregtimi në ALPEX vetëm me Urdhërporosi të Thjeshta (Simple Orders) do të jetë me afat të përkohshëm, deri në një moment të dytë kur ALPEX-i do të vlerësojë se është garantuar likuiditeti i nevojshëm për të filluar tregtimin me Urdhërporosi në Bllok dhe Anëtarët kanë fituar njohuritë e nevojshme për operimin në Platformat e Bursës.

Vlerësojmë se vendimi për fillimin e tregtimit në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a, me produkte orare dhe lloji i urdhërporosi të jetë Urdhërporosi e Thjeshtë do të ishte një vendim i domosdoshëm për funksionimin e duhur të tregut të organizuar me shumicë të energjisë elektrike.

Përsa më sipër, informojmë:

- Me fillimin e operimin e tregut nga Bursa Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a për një periudhë pa afat, do të tregtohen produkte orare nëpërmjet urdhërporosisë të llojit Urdhërporosi e Thjeshtë (Simple Orders). ALPEX do t'ju informojë paraprakisht kur do vendosi të prezantoj produktet dhe llojet e urdhërporosive të tjera siç parashikohen në Procedurën e Tregtimit në ALPEX për tregtim.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi të hapur për çdo kërkesë apo sqarim të mundshëm.

Me respekt,

ADMINISTRATOR i ALPEX sh.a

Sokol Dishnica

